



MUAJI MARS

- 1. E hënë.** Oshënare dëshmore Evdhokia. Dëshmorët Markeli dhe Andoni. Dëshmore Andonina. Albini i Anzherit.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së hënës së javës së 35-të të Letrave (1 Jn. 2:18-3:8).

UNGJILLI i së hënës së Mishndalimit (Para së Dielës së të Lidhurit të Mishit) (Mk. 11:1-11).

- 2. E martë.** Dëshmor Isihi. Dëshmore Eftalia. Oshënar Nikolla Plana. Omologjet Koindi.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së martës së javës së 35-të të Letrave (1 Jn. 3:9-22).

UNGJILLI i së martës së Mishndalimit (Mk. 14:10-42).

- 3. E mërkurë.** Dëshmorët Eftropi, Kleoniku dhe Vasilisku. Hierodëshmor Theodoriti.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së mërkurës së javës së 35-të të Letrave (1 Jn. 3:21-4:11).

UNGJILLI i së mërkurës së Mishndalimit (Mk. 14:43-15:1).

4. E enjte Oshënar Gjerasimi në Jordan. Dëshmorët Pavli dhe Juliana dhe të tjerë me ta.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së enjtes së javës së 35-të të Letrave (1 Jn. 4:20-5:20).

UNGJILLI i së enjtes së Mishndalimit (Mk. 15:1-15).

5. E premte. Oshënar dëshmor Kononi. Dëshmor Konon Kopshtari. Dëshmorët Onisi dhe Arkelau. Dëshmore Iraida. Oshënar Virgjili.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së premtes së javës së 35-të të Letrave (2 Jn. 1-13).

UNGJILLI i së premtes së Mishndalimit (Mk. 15:20, 22, 25, 33-41).

6. † E shtunë. E Shpirtrave (Kujtimi i të gjithë të krishterëve shpresëtarë që kanë ndërruar jetë ndër shekuj). Kujtimi i gjetjes së Kryqit nga shën Elena. 42 dëshmorët në Amor.

Shërbesat psalen sipas rendit të librit të Triodit.

7. † **E DIEL. TË LIDHURIT E MISHIT** (Kujtimi i Ardhjes së Dytë dhe të lavdishme të Zotit tonë Jisu Krisht - Gjykimi i fundit). Hierodëshmorët Efremi, Vasileu, Evgjeni etj.

Tingulli Tërthor II. Ungjilli mëngjesor ngjallësor VI.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...”, thuhet 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 Vargëzimet e përshembullta të Triodit. “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. Tërth. II: “Cili nuk do të të lumërojë...”.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe PARAVARGU i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, Hyjlindësorja e Pasvargjeve të tingullit, por sipas tingullit të Lavdisë.

PËRLËSHORET ngjallësore: “Fuqitë engjëllore...”. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja: “Ti që quajte nënën tënde...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja ngjallësore: “Fuqitë engjëllore...”. “Lavdi...”, po ajo: “Fuqitë engjëllore...”. “Tani...”, Hyjlindësorja: “Ti që quajte nënën tënde...”.

NDENJËSORET ngjallësore sipas radhës.

BEKIMTORET ngjallësore, DËGJIMI, SHKALLESAT dhe PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA (e tingullit dhe e Triodit), SHTËPIA (e tingullit dhe e Triodit), SINAKSARI (i ditës dhe i Triodit).

ZBRITËSORET: “Ti më ndih, ti më përkrah...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor ngjallësor VI.

Pas Ungjillit, lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet PSALMI 50. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”, “Hapmi dyert e pendimit...”. “Tani...”, “Drejtomë në rrugët...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, “Unë i mjeri, duke kujtuar...”. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe në fund Zbritësorja IX: “Qysh linde nuk merret vesh...”.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore VI dhe e Triodit.

LAVDËRIMET: 5 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e vetëmelodishme të Triodit. “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, “E përmbibekuar je, o Hyjlindëse...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e të dielave.

Pas HYRJES, Përlëshorja ngjallësore dhe e shenjtit të kishës.

SHKURTORJA e Triodit.

Paravargu dhe Aliluari i së dielës.

APOSTULLI i së Dielës së të Lidhurit të Mishit (1 Kor. 8:8-9:2).

UNGJILLI i së Dielës së të Lidhurit të Mishit (Mtth. 25:31-46).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.

MARS

KUNGATORJA e së dielës: “Lavdëroni Zotin...”.
“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

- 8. E hënë.** Apostull Ermia, nga të 70-t. Dëshmor Dioni. Oshënar Theofilakti i Nikomedisë.

Hahet bulmet e peshk.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së hënës së Ngrënies së Djathit (3 Jn. 1-15).

UNGJILLI i së hënës së Ngrënies së Djathit (Llk. 19:29-40, 22:7-39).

- 9. † E martë.** 40 dëshmorët në Sebasti (Flavio, Viviani, Melitoni, Sisini, Aeti, Valeri etj.).

Hahet bulmet e peshk.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 3 Vargëzimet e përshebullta të shenjtoreve, të cilat bëhen 6 (thuhet të gjitha nga 2 herë). “Lavdi...”, e shenjtoreve. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike në të njëjtin tingull me Lavdinë e shenjtoreve.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, PARAVARGU i ditës.

PASVARGJET e shenjtoreve. “Lavdi...”, e shenjtoreve. “Tani...”, Hyjlindësorja në të njëjtin tingull me Lavdinë e Pasvargjeve të shenjtit.

PËRLËSHORJA e shenjtoreve: “Për mundimet që pësuan...”. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja: “Gabrieli kur të tha...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja e shenjtoreve: “Për mundimet që pësuan...”. “Lavdi...”, po ajo: “Për mundimet që pësuan...”. “Tani...”, Hyjlindësorja: “Gabrieli kur të tha...”.

NDENJËSORET e shenjtoreve.

SHKALLESAT: “Që prej rinisë sime...” dhe Paravargu i shenjtoreve.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor i shenjtoreve (kërkoje të martën e javës së 12-të të Llukait – Llk. 21:12-19).

Pas Ungjillit lexohet PSALMI 50. Pas Psalmit 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Atloforëve...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, tropari i shenjtoreve. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e shenjtoreve. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET: “Ja gojën e çel...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe Zbritësorja IX: “Gjithë njerëzit...”.

DËRGIMSORET e shenjtoreve.

LAVDËRIMET: psalen 3 Vargëzimet e përshembullta të shenjtoreve, të cilat bëhen 4. “Lavdi...”, e shenjtoreve. “Tani...”, Hyjlindësorja në të njëjtin tingull me Lavdinë e shenjtoreve.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe Përlëshorja e shenjtoreve.

Në Liturgji:

ANDIFONET e të kremteve të dëshmorëve.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja e shenjtoreëve: “Për mundimet që pësuan...” dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja: “Mbrojtje e paturpëruar...”.

APOSTULLI i shenjtoreëve (kërkoje më 9 mars – Heb. 12:1-10).

UNGJILLI i shenjtoreëve (kërkoje të mërkurën e javës së 9-të të Mattheut – Mtth. 20:1-16).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.

KUNGATORJA: “I drejti do të kujtohet...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

Të martën **në mbrëmje**, kryhet MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës.

10. E mërkurë. Dëshmor Kodrati në Korinth dhe 5 dëshmorët me të. Anastasia, patrice. Dëshmor i ri Mihaili.

Hahet bulmet e peshk.

Shënim: *Siç ka mbizotëruar në të gjitha Kishat Orthodhokse, të mërkurën dhe të premten e të Ngrënies së Djathit nuk kryhet as Liturgjia Hyjnore e Shën Joan Gojartit, as Liturgjia Hyjnore e Dhuratave të Parashenjtëruara. Nëse në këto ditë rastis kujtimi i ndonjë shenjtori të madh kremtues, atëherë shërbesa e Triodit nuk thuhet, dhe psalet vetëm shërbesa e shenjtorit. Në këtë rast, kryhet Liturgjia Hyjnore e Shën Joan Gojartit.*

Të mërkurën **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Joeli 2:12-36).

11. E enjte. Sofroni, patriark i Jerusalemit. Dëshmorët Pioni, Trofimi dhe Thali. Oshënare Theodhora në Artë. Dëshmore Alberta.

Hahet bulmet e peshk.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së enjtes së Ngrënies së Djathit (Jud. 11-25).

UNJILLI i së enjtes së Ngrënies së Djathit (Llk. 23:1-31, 33, 44-56)

Të enjten **në mbrëmje**, kryhet MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës.

12. E premte. Theofan Omologjeti (Pohuesi). Grigor Dialogu i Romës. Simeoni, Theologu i Ri.

Hahet bulmet e peshk.

Të premten **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Zak. 8:7-17).

13. † E shtunë. (Kujtimi i burrave dhe grave që shkëlqyen në asketizëm). Transferimi i lipsanit të Niqiforit të Konstandinopojës. Oshënar Gerald dhe Ramiri.

Hahet bulmet e peshk.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i oshënarëve (Gal. 5:22-6:2).

UNJILLI i së shtunës së Ngrënies së Djathit (Mth. 6:1-13)

14. † E DIEL. TË LIDHURIT E DJATHIT (Kujtimi i dëbimit të të parakrijuarit Adam nga Parajsa - Falja dhe kreshmimi). Oshënar Benedikti. Ep. Bonifati në Skoci. Mbretëresha Matilda.

Tingulli i Rëndë. Ungjilli mëngjesor ngjallësor VII.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...”, thuhet 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 Vargëzime të Triodit. “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. Rëndë: “Ti u njohet si Nënë përmbi natyrën...”.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe PARAVARGU i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, Hyjlindësorja e Pasvargjeve të tingullit, por sipas tingullit të Lavdisë.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Dërrmove vdekjen...”. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja: “Si thesar i ngjalljes sonë...”.

Në mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, psallet Përlëshorja ngjallësore: “Dërrmove vdekjen...”. “Lavdi...”, po ajo: “Dërrmove vdekjen...”. “Tani...”, Hyjlindësorja: “Si thesar i ngjalljes sonë...”.

NDENJËSORET ngjallësore sipas radhës.

BEKIMTORET ngjallësore, DËGJIMI, SHKALLESAT dhe PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA (e tingullit dhe e Triodit), SHTËPIA (e tingullit dhe e Triodit), SINAKSARI (i ditës dhe i Triodit).

ZBRITËSORET: “E kapërceu me këmbë detin...” (kërkoji të dielën e Fariseut dhe Tagrambledhësit).

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor ngjallësor VII.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet PSALMI 50. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”, “Hapmi dyert e pendimit...”. “Tani...”, “Drejtomë në rrugët...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, “Unë i mjeri, duke kujtuar...”. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe në fund Zbritësorja IX: “Asnjë njeri Perëndinë...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore VII dhe dy Dërgimsoret e Triodit.

LAVDËRIMET: 5 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e vetëmelodishme të Triodit. “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, “E përmbibekuar je, o Hyjlindëse...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e të dielave.

Pas HYRJES, Përlëshorja ngjallësore dhe e shenjtit të kishës.

SHKURTORJA e Triodit.

Paravargu dhe Aliluari i së dielës.

APOSTULLI i së dielës së të Lidhurit të Djathit (Rom. 13:11-14:4).

UNGJILLI i së dielës së të Lidhurit të Djathit (Mtth. 6:14-21).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.

KUNGATORJA e së dielës: “Lavdëroni Zotin...”.
 “PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

TË DIELËN NË MBRËMJE.

MBRËMËSORJA KATANIKTIKE (E FALJES).

“I BEKUAR është Perëndia ynë...”, “Ejani t’i falemi...”
 (3 herë), PSALMI NISTOR (Ps. 103) dhe PAQËSORET.

Pas “O ZOT, THIRRA...”, thuhet 4 Vargëzime kataniktike të Ting. të Rëndë, 3 Vargëzime të Triodit dhe 3 të Mujorit. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja e përshembullit të Mujorit.

HYRJJA me temjanicë (kështu veprohet në të gjitha mbrëmësoret e të dielave të Kreshmës së Madhe, të cilat kanë Paravarg të madh). “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”. PARAVARGU i Madh: “Mos e kthe mënjane...”.

Lutja e Gjerë, “Bëna të denjë...” dhe Plotësoret.

PASVARGJET: pasvargu i vetëmelodishëm i Triodit, 2 herë dhe tropari martirik, 1 herë. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja e përshembullit.

“Tani përlëshoje...”, Trishenjti.

TROPARET: “Gëzohu, o Hirplote...”, “O Pagëzor i Krishtit...” etj.

“Mëshiro, o Zot” (40 herë). “Lavdi...” dhe “Tani...”, “Më të nderuarën...”, “Beko, o atë, në emrin e Zotit...”. Prifti: “Ai që është i bekuar...”, “O Mbret qiellor...” dhe tri metanitë e mëdha së bashku me lutjen e shën Efremit.

PËRLËSHIMI: “Krishti, Perëndia ynë i vërtetë, që është...” (ku kujtohet shenjtori i ditës pasardhëse).

Para se të thotë: “Me uratat...”, kori psal: “Gjithë sa përikin i përkrah...”.

Gjatë kësaj kohe, klerikët dhe laikët i kërkojnë falje njëri-tjetrit.

Në fund, thuhet: “Me uratat...”.

Shënim: *Rregulli i mësipërm i Mbrëmësores kataniktike ndiqet për të gjitha mbrëmësoret kataniktike të të pesë të dielave pasardhëse të Triodit, por në çdo të diel thuhet tropare të ndryshme kataniktike të tingullit të çdo jave dhe të Triodit.*

- 15. E hënë. E bardhë.** Apostull Aristovuli nga të 70-t, në Britani. Dëshmorët Agapi, Romili, Tïmolau etj. Dëshmor i ri Manueli.

Fillon Kreshma e Madhe.

Të hënë **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 1:1-20).

Të hënë **në mbrëmje**, MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës (**Leximi I:** Gjen. 1:1-13; **Leximi II:** Fja. Urt. 1:1-20).

PASDARKA E MADHE (Ungjilli Llk. 21:8-36).

- 16. E martë. E bardhë.** Dëshmorët Savini, Juliani. Oshënarët Kristodhuli dhe Anini, mrekullibërës.

Të martën **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 1:19-2:3).

Të martën **në mbrëmje**, MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës (**Leximi I:** Gjen. 1:14-23; **Leximi II:** Fja. Urt. 1:20-33).

PASDARKA E MADHE (Ungjilli Mtth. 6:1-13).

- 17. † E mërkurë. E bardhë.** Oshënar Aleksi, njeriu i Perëndisë. Episkop Patriku, ndriçues i Irlandës.

Të mërkurën **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 2:3-11).

MBRËMËSORJA dhe LITURGJIA e Dhuratave të Parashenjtëruara (**Leximi I:** Gjen. 1:24-2:3; **Leximi II:** Fja. Urt. 2:1-22).

Të mërkurën **në mbrëmje**, PASDARKA E MADHE (Ungjilli Mk. 11:22-26, Mtth. 7:7-8).

- 18. E enjte.** Kirili i Jerusalemit. Dëshmor Eduardi, princ në Angli. Frediani i Lukës.

Të enjten **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 2:11-21).

Të enjten **në mbrëmje**, MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës (**Leximi I:** Gjen. 2:4-19; **Leximi II:** Fja. Urt. 3:1-19).

PASDARKA E MADHE (Ungjilli Mtth. 7:7-11).

- 19. † E premte.** Dëshmorët Krisanthi dhe Daria. Dëshmorët Klaudi, Ilaria, Jasoni dhe Mauri.

I e Akathistit

Të premten **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 3:1-14).

MBRËMËSORJA dhe LITURGJIA e Dhuratave të Parashenjtëruara (**Leximi I:** Gjen. 2:20-3:20; **Leximi II:** Fja. Urt. 3:19-34).

Të premten **në mbrëmje**, shërbesa e HIMNIT AKATHIST drejtuar Hyjlindëses (Qëndrimi I).

Lexohet Pasdarka e Vogël deri te “Të meriton...”. Pas “Të meriton...” psalet kanoni i Himnit Akathist: “Ja gojën e çel...” dhe pas tij psalet: “Përlufteshës gjenerale...”. Më pas lexohet Qëndrimi i parë i Përshëndetjeve të Hyjlindëses. Pas tyre psalet sërish: “Përlufteshës gjenerale...”. Thuhet Trishenjti dhe Shkurtorja e dëshmorit të madh Theodhor Tironi. Më pas thuhet: “Mëshiro, o Zot” (40 herë), “O Krisht Perëndi, që adhurohesh...” dhe pjesa e mbetur e Pasdarkës së Vogël. Pas troparit: “Gjithë shpresën time e vë tek ti...”, lexohet Ungjilli (Jn. 15:1-7). Në vazhdim bëhet Përlëshimi i Vogël, thuhet: “Le të lutemi për...”, psalet: “O bukuri me nam...” dhe në fund thuhet: “Me uratat...”.

Shënim: *Rregulli i mësipërm ndiqet edhe për tri të premtet pasardhëse, domethënë të premtën dytë, të tretë dhe të katërt, por pa lexuar Ungjill, i cili lexohet vetëm të premtën e parë. Në tri të premtet pasardhëse lexohet Shkurtorja e së shtunës: “Si frytet e natyrës...”, sepse në këto të shtuna nuk rastis ndonjë shenjtor i madh kremtues.*

20. † E shtunë. Kujtimi i mrekullisë së grurit nga shën Theodhori. Oshënarët dëshmorë të manastirit të Shën Savës. Dëshmoret Aleksandria dhe Klaudia.

Shënim: *Të shtunave të Kreshmës së Madhe, në mëngjes, kryhet shërbesa e Mëngjesores dhe Liturgjia Hyjnore e Shën Joan Gojartit, ndërsa në mbrëmje kryhet, si zakonisht, shërbesa e Mbrëmësores të së dielës pasardhëse. Të dielave kryhet Liturgjia e Shën Vasilit të Madh.*

Të shtunën në mëngjes, **në Mëngjesore:**

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...” thuhet PËRLËSHORJA e shenjtit: “Çudira të mëdha...”. “Lavdi...”, po ajo: “Çudira të mëdha...”. “Tani...”, Hyjllindësorja: “Të gjitha përmbi mendim...”.

NDENJËSORET e Triodit. Psalmi 50 (lexohet).

SHKURTORJA, SHTËPIA dhe SINAKSARI i shenjtit.

ZBRITËSORET: “Ja gojën e çel...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjllindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe në fund Zbritësorja IX: “Gjithë njerëzit...”.

DËRGIMSORET, VARGËZIMET E LAVDËRIMEVE, “Lavdi” dhe “Tani” thuhet siç janë në librin e Triodit.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe PËRLËSHORJA e shenjtit.

Në Liturgji:

ANDIFONET e përditshme.

Pas HYRJES, Përlëshorja e shenjtit: “Çudira të mëdha...” dhe e shenjtit të kishës.

SHKURTORJA: “Mbrojtje e paturpëruar...”.

APOSTULLI i shenjtit (kërkoje më 26 tetor - 2 Tim. 2:1-10).

UNJILLI i ditës (Mk. 2:23-3:5).

Vazhdimi i Liturgjisë së Shën Joan Gojartit.

“TË MERITON...” dhe KUNGATORJA: “Kujtimi i të drejtit...”.

Pas uratës së Pasamvonës: “O Zot, që bekon ata që të bekojnë...”, bëhet bekimi i grurit kremtues. Më pas psalet: “Emri i Zotit...” dhe bëhet Përlëshimi.

Shënim: *Duhet të dimë që, sipas traditës së vjetër, e cila reflektohet edhe në Tipikonë që është ende në fuqi, në ditën e sotme sillet për t'u bekuar grurë i veçantë në kujtim të dëshmorit të madh që kremton sot dhe në kujtim të mrekullisë së grurit që u krye prej tij, për të cilën flet edhe shërbesa e Triodit. Por, meqenëse të shtunave ekziston tradita tjetër e sjelljes në kishë të grurit për të fjeturit dhe e kryerjes së Trisaisë së përmortshme, gjykojmë të drejtë që fillimisht, pas uratës së Pasamvonës, të kryhet bekimi i grurit kremtues të sjellë për nder të shën Theodorit dhe në fund të Liturgjisë, pas “Me uratat...”, prifti le të thotë: “I bekuar është Perëndia...” dhe të kryejë Trisainë e zakonshme të përmortshme për grurin që besimtarët kanë sjellë për të fjeturit.*

21. † E DIEL. I E KRESHMËS (E Orthodhoksisë).

Jakov Omologjeti (Pohuesi). Dëshmorët Filimoni, Domnini. Oshënar Serapioni në Egjipt.

Tingulli Tërthor IV. Ungjilli mëngjesor ngjallësor VIII.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...”, thuhet 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 Vargëzime të Triodit. “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. Tërth. IV: “Mbreti i qiejve...”.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe PARAVARGU i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...” dhe Tani, e Triodit.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Që lartazi zbrite...”.
 “Lavdi...”, e së kremtes: “Ikonën e bekuar...”. “Tani...”,
 Hyjlindësorja: “Të gjitha përmbi mendim...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, Përlëshoret psalen
 si në Mbrëmësore. NDENJËSORET ngjallësore sipas
 radhës, por në vend të Hyjlindësores së stikologjisë
 (grupit) së parë, psalet Hyjlindësorja e Përlëshoreve të
 tingullit: “Ti që linde për ne...”.

BEKIMTORET ngjallësore, DËGJIMI, SHKALLESAT
 dhe PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA (e tingullit dhe e Triodit), SHTËPIA (e
 tingullit dhe e Triodit), SINAKSARI (i ditës dhe i Triodit).

ZBRITËSORET: “Kaloj në mes të Detit të Kuq...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI
 mëngjesor ngjallësor VIII.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe
 psalet PSALMI 50. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”,
 “Hapmi dyert e pendimit...”. “Tani...”, “Drejtomë në
 rrugët...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, “Unë i mjeri, duke
 kujtuar...”. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin
 tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe
 Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe në
 fund Zbritësorja IX.

DËRGIMSORJA ngjallësore VIII dhe e Triodit.

LAVDËRIMET: 4 Vargëzime ngjallësore dhe
 3 Vargëzimet e përshembullta të Triodit, të cilat bëhen
 4 (e para thuhet 2 herë). “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”,
 “E përmbibekuar je, o Hyjlindëse...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe.

Pas “Shenjt Perëndi...” të Dhoksologjisë së Madhe (ose pas uratës së Pasamvonës në Liturgji), kryhet litania me Kryqin e nderuar dhe me ikonat e shenjta, si më poshtë:

LITANIA E IKONAVE TË SHENJTA

Klerikët dhe laikët, duke dalë nga Shenjtërorja me Kryqin dhe ikonat e shenjta në duar, në formë litanie, sipas traditës, vijnë një herë rreth e qark kishës (jashtë ose brenda saj), ndërkohë që kambanat e saj bien në mënyrë kremtuese, ndërsa koret psalin Përlëshoren: “Ikonën e bekuar...”, dhe bëjnë katër ndalesa në të katër anët e kishës. Në secilën prej ndalesave thuhën këto urata:

a. Në anën jugore të kishës, thuhën lutjet për të gjallët.

b. Në pjesën e lindore të kishës, thuhën lutjet për të fjeturit ndër shekuj, për mbretërit shpresëtarë, për patriarkët orthodhoksë, për kryepriftërinjtë etj. Koret psalin: “I përjetshëm kujtimi...” (3 herë) dhe thirrja: “Se Ti je Ngjallja...”.

c. Në pjesën veriore të kishës, thuhën lutje për të gjallët, si në ndalesën e parë.

d. Para derës veriore të kishës ose brenda në kishë (te solea), thuhën lutje për të gjallët dhe në fund thuhet: “Le të lutemi për ruajtjen e kësaj kishë...”, “Dëgjona, o Perëndi...” etj. Dhe prifti i parë në radhë (ose kryepriifti) lexon vendimin e Sinodit rreth triumfit të Orthodhoksisë: “Siç e panë profetët, siç mësuan apostujt...”.

Në fund, futen brenda në kishë dhe psalet Paravargu i madh: “Cila Perëndi...” dhe më pas thuhet: “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e së kremtes.

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi... Shpëtona... që u ngjalle së vdekurish...”.

Pas HYRJES, Përlëshorja ngjallësore, e Triodit dhe e shenjtit të kishës.

SHKURTORJA e Triodit.

Paravargu dhe Aliluari i së dielës.

APOSTULLI i së dielës I të Kreshmës (Heb. 11:24-26, 32-40).

UNGJILLI i së dielës I të Kreshmës (Jn. 1:44-52).

Dhe vazhdon Liturgjia e Shën Vasilit të Madh.

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Me ty gëzohet...”.

KUNGATORJA: “Lavdëroni Zotin...”.

“Pamë dritën...” dhe pjesa e fundit e Liturgjisë.

Të dielën **në mbrëmje**, kryhet MBRËMËSORJA kataniktike.

22. E hënë. Hierodëshmor Vasili i Angirës. Dëshmore Kalinika. Dëshmor Oktaviani. Dëshmore Dhrosidha.

Të hënë **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 4:2-6, 5:1-7).

Të hënë **në mbrëmje**, MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës (**Leximi I:** Gjen. 3:21-4:7; **Leximi II:** Fja. Urt. 3:34-4:22).

PASDARKA E MADHE.

23. E martë. Dëshmor Nikoni dhe 199 nxënësit e tij. Dëshmor Dometi. Dëshmori i ri Lluka.

Të martën **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 5:7-16).

Të martën **në mbrëmje**, MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës (**Leximi I:** Gjen. 4:8-15; **Leximi II:** Fja. Urt. 5:1-15).

PASDARKA E MADHE.

24. E mërkurë. Hierodëshmor Artemoni i Seleucisë. Hierodëshmori i ri Partheni i Konstandinopojës.

Të mërkurën **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 5:16-25).

Shënim: *Liturgjia e Dhuratave të Parashenjtëruara nuk kryhet, sepse të mërkurën në mbrëmje kryhet Mbrëmësorja e Madhe Kremtuese e Ungjillëzimit të Hyllindëses, si më poshtë:*

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...”, thuhet 3 Vargëzimet e së kremtes, të cilat bëhen 6, duke u thënë nga dy herë. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

HYRJA me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, Paravargu i ditës dhe leximet biblike (**Leximi I:** Gjen. 28:10-17; **Leximi II:** Ezek. 43:27-44:4 **Leximi III:** Fja. Urt. 9:1-11).

PASVARGJET e vetëmelodishme të së kremtes. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

PËRLËSHORJA e së kremtes (3 herë).

PËRLËSHIMI: “Ai që pranoi të mishërohet prej Shpirtit të Shenjtë dhe Virgjëreshës Mari për ne njerëzit dhe për shpëtimin tonë, Krishti, Perëndia ynë i vërtetë,

me ndërmjetimet e Nënës së tij të tërëkulluar, Ungjillëzimin e së cilës kremtojmë sot..., të Hyjprindërve të shenjtë dhe të drejtë Joakim dhe Ana, dhe të gjithë shenjtorëve, na mëshiroftë...”.

25. † E ENJTE. UNGJILLËZIMI I HYJLINDËSES MARI (VANGJELIZMOI).

Hahet vaj, verë dhe peshk.

Të enjten në **mëngjes** kryhet:

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja e së kremtes (3 herë).

NDENJËSORET e së kremtes sipas radhës. SHKALLESAT: “Që prej rinisë...” dhe PARAVARGU i së kremtes.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor i së kremtes.

Pas Ungjillit lexohet PSALMI 50. Pas Psalmit 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, tropari i së kremtes. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

SHKURTORJA, SHTËPIA dhe SINAKSARI i së kremtes.

ZBRITËSORET: “Ja gojën e çel...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, në vend të: “Më të nderuarën...”, psalen Madhështimet e së kremtes dhe Zbritësorja IX: “Gjithë njerëzit...”.

DËRGIMSORJA dhe LAVDËRIMET e së kremtes.
DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe Përlëshorja e së kremtes (1 herë).

Në Liturgji:

ANDIFONET e së kremtes.

HYRTORJA: *“Ungjillëzoni shpëtimin e Perëndisë ditë për ditë. Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, që u mishërove për ne, ne që të psalim: Aliluia”.*

Pas HYRJES, Përlëshorja e së kremtes dhe SHKURTORJA: “Përlufteshës gjenerale...”.

Paravargu dhe Aliluari i së kremtes.

APOSTULLI i së kremtes (Heb. 2:11-18).

UNGJILLI i së kremtes (Llk. 1:24-38).

Dhe vazhdon si zakonisht Liturgjia e shën Joan Gojartit.

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...” thuhet Madhështimi i së kremtes.

KUNGATORJA: “Zoti e ka zgjedhur Sionin dhe e ka dashur për banesë”.

“PAMË DRITËN e vërtetë...” dhe Përlëshimi si në Mbrëmësore.

Të enjten **në mbrëmje**, bëhet Mbyllja (Përlëshimi) e Ungjillëzimit të Hyjlindëses.

Mbrëmësorja e mbylljes:

“I BEKUAR është Perëndia ynë...”, “Ejani t’i falemi...” (3 herë), PSALMI NISTOR (Ps. 103) dhe PAQËSORET.

Pas “O ZOT, THIRRA...”, thuhet 3 Vargëzimet e përshembullta të së kremtes (25 mars) dhe të 3 Vargëzimet e Kryeengjellit (26 mars). “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes (25 mars).

Hyrja me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, Paravargu i ditës. Leximet biblike të së kremtes nuk thuhën.

PASVARGJET e vetëmelodishme të së kremtes. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes (kërkoji më 25 mars).

PËRLËSHORJA e së kremtes (3 herë).

PËRLËSHIMI: “Ai që pranoi të mishërohet prej Shpirtit të Shenjtë dhe Virgjëreshës Mari për ne njerëzit dhe për shpëtimin tonë, Krishti, Perëndia ynë i vërtetë, me ndërmjetimet e Nënës së tij të tërëkulluar, Ungjillëzimin e së cilës kremtojmë sot..., të Hyjprindërve të shenjtë dhe të drejtë Joakim dhe Ana, dhe të gjithë shenjtorëve, na mëshiroftë...”.

26. † E premte. Mbledhja adhuruese në nderim të Kryeengjëllit Gavriil. Hierodëshmor Montani dhe Maksima, e shoqja. 26 martirët në Goti.

II e Akathistit.

Të premtën **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 7:1-14).

MBRËMËSORJA dhe LITURGJIA e Dhuratave të Parashenjtëruara (**Leximi I:** Gjen. 5:32-6:8; **Leximi II:** Fja. Urt. 6:20-7:1).

Të premtën **në mbrëmje**, shërbesa e HIMNIT AKATHIST drejtuar Hyjlindëses (Qëndrimi II). Lexohet Pasdarka e vogël deri te “Të meriton...”. Pas “Të meriton...” psalet kanoni i Himnit Akathist: “Ja gojën e çel...” dhe pas tij psalet: “Përlufteshës gjenerale...”. Më pas lexohet Qëndrimi i dytë i Përshëndetjeve të

Hyjlindëses. Pas tyre, psalet sërish: “Përlufteshës gjenerale...”. Thuhet Trishenjti dhe Shkurtorja e ditës. Më pas thuhet: “Mëshiro, o Zot” (40 herë), “O Krisht Perëndi, që adhurohesh...” dhe pjesa e mbetur e Pasdarkës së Vogël.

27. † E shtunë. Dëshmore Matrona. Dëshmorët Filiti dhe Lidia. Roberti, ndriçues i Bavarisë dhe Austrisë.

Të shtunën në mëngjes, **Mëngjesorja** e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i së shtunës së javës së 2-të të Kreshmës (Heb. 3:12-16).

UNGJILLI i së shtunës së javës së 2-të të Kreshmës (Mk. 1:35-44).

28. † E DIEL. II KRESHMËS (Shën Grigor Pallamai).

Apostull Herodioni, nga të 70-t. Oshënar Ilarioni i Ri. Oshënar Stefan Mrekullibërësi.

Tingulli I. Ungjilli mëngjesor ngjallësor IX.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...”, thuhet 6 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e Triodit, të cilat bëhen 4 (e para thuhet 2 herë). “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. I: “Lavdinë e përbotshme...”.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe PARAVARGU i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, Hyjlindësorja e Pasvargjeve të tingullit, por në të njëjtin tingull me Lavdinë e Triodit.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Guri kur u vulos...”. “Lavdi...”, e Triodit: “Yll i ndritshëm Orthodhoks...”. “Tani...”, Hyjlindësorja: “Ti që linde për ne...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, Përlëshoret psalen si në Mbrëmësore. NDENJËSORET ngjallësore sipas radhës, por në vend të Hyjlindësores së stikologjisë (grupit) së parë, psalet Hyjlindësorja e Përlëshoreve të tingullit: “Gabrieli kur të tha...”.

BEKIMTORET ngjallësore, DËGJIMI, SHKALLESAT dhe PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA (e tingullit dhe e Triodit), SHTËPIA (e tingullit dhe e Triodit) dhe SINAKSARI (i ditës dhe i Triodit).

ZBRITËSORET: “Ja gojën e çel tani...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor ngjallësor IX.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet PSALMI 50. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”, “Hapmi dyert e pendimit...”. “Tani...”, “Drejtomë në rrugët...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, “Unë i mjeri, duke kujtuar...”. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe në fund Zbritësorja IX: “Gjithë njerëzit...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore IX dhe e Triodit.

LAVDËRIMET: 4 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e përshembullta të Triodit, të cilat bëhen 4 (e para thuhet 2 herë). “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, “E përmbibekuar je, o Hyjlindëse...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe, “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e të dielave.

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi... Shpëtona... që u ngjalle së vdekurish...”.

Pas HYRJES, Përlëshorja ngjallësore, e Triodit dhe e shenjtit të kishës.

SHKURTORJA e Triodit: “Përlufteshës...”.

Paravargu dhe Aliluari i tingullit.

APOSTULLI i së dielës së 2-të të Kreshmës (Heb. 1:10-2:3).

UNGJILLI i së dielës së 2-të të Kreshmës (Mk. 2:1-12).

Dhe vazhdon Liturgjia e Shën Vasilit të Madh.

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Me ty gëzohet...”.

KUNGATORJA: “Lavdëroni Zotin...”.

“Pamë dritën...” dhe pjesa e fundit e Liturgjisë.

Të dielën **në mbrëmje**, kryhet MBRËMËSORJA kataniktike.

29. E hënë. Hierodëshmor Marku i Arethusës. Dëshmor Kirili, Varahisi etj. në Persi.

Të hënë **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 8:13-9:7).

Të hënë **në mbrëmje**, MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës (**Leximi I:** Gjen. 6:9-22; **Leximi II:** Fja. Urt. 8:1-21).

PASDARKA E MADHE.

30. E martë. Profeti Joad. Oshënar Joani i Shkallës. Oshënar Joani në pus. Shën Evula.

Të martën **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 9:8-10:4).

Të martën **në mbrëmje**, MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës (**Leximi I:** Gjen. 7:1-5; **Leximi II:** Fja. Urt. 8:32-9:11).

PASDARKA E MADHE.

31. † E mërkurë. Hierodëshmor Ipati i Gangrës. Omologjet Akaki. Inocenti, ndriçuesi i Alaskës. Dëshmor Menandri.

Të mërkurën **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 10:12-20).

MBRËMËSORJA dhe LITURGJIA e Dhuratave të Parashenjtuara (**Leximi I:** Gjen. 7:6-9; **Leximi II:** Fja. Urt. 9:12-18).

Të mërkurën **në mbrëmje**, PASDARKA E MADHE.